



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 1182 prot.

Tiranë, më 10.04.2025

REKOMANDIM

Nr. 16, datë 10.04.2025

PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS TË AUTORITETIT PUBLIK SPITALI RAJONAL DURRËS.

Në mbështetje të neneve 4, 6, 7, si dhe shkronjës f) të nenit 9/1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar (në vijim LDI),

KONSTATOVA SE:

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) është përgjegjëse për monitorimin dhe mbikëqyrjen e transparencës proaktive të autoriteteve publike. Në përmbushje të këtij detyrimi ligjor, vlerësohet se institucionet e sistemit shëndetësor publik, për shkak të funksionit, shpërndarjes territoriale dhe shërbimeve që ofrojnë për popullatën, përbëjnë një kategori të rëndësishme të autoriteteve publike.

Ligji nr. 55/2022 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” (në vijim Ligji nr. 55/2022), në pikën 1 të nenit 13, përcakton llojin e strukturave shëndetësore: “*Spitale publike sipas kategorisë ndahen në: a) spitale ditore; b) spitale në nivel bashkie; c) spitale në nivel qarku; ç) qendër spitalore rajonale; d) spitale terciare; dh) spitale/qendra spitalore universitare*”.

Në zbatim të këtij ligji, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 36, datë 27.1.2023 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e spitaleve rajonale, terciare dhe qendrave spitalore rajonale publike”, ku përcaktohen kriteret e përgjithshme për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këtyre institucioneve shëndetësore publike.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 15, datë 9.1.2025 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2025” është përcaktuar se Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor

nënshkruan marrëveshje me këto struktura spitalore publike për kategoritë e shërbimeve shëndetësore të ofruara prej tyre.

Nga ana tjetër, autonomia spitalore, si pjesë integrale e menaxhimit të sistemit spitalor publik, garanton barazi, aksesueshmëri, cilësi, siguri dhe ofrimin e shërbimit shëndetësor në kohë për pacientin. Referuar Ligjit nr. 55/2022, spitalet autonome organizohen në formën e personit juridik publik, me të drejta, detyrime dhe përgjegjësi të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Autonomia spitalore ka për synim të sigurojë:

- efektivitet dhe transparencë në menaxhimin administrativ të burimeve financiare dhe
- burimeve njerëzore;
- rritje të transparencës dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve;
- përmirësim të mobilizimit të burimeve njerëzore dhe financiare;
- rritje të rolit të komunitetit në vendimmarrje.

Në pikën 1 të nenit 2 të LDI përcaktohet se: “Autoritet publik” a) është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike”.

Për sa më sipër, Spitali Rajonal Durrës konsiderohet autoritet publik, në kuptim të LDI.

Autoritetet publike, bazuar në pikën 1 të nenit 4 të LDI, kanë detyrimin të vënë në zbatim programin institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë, si dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni/dokumentacioni. Gjithashtu, në pikat 2 dhe 3 të këtij neni përcaktohet se:

“2. Në përgatitjen e projektprogramit të transparencës, autoriteti publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

- a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;*
- b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;*
- c) modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.*

3. Programi i transparencës bëhet publik në faqen zyrtare në internet të autoritetit publik”.

Programi i Transparencës vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës autoriteti publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet pasurimit dhe përditësimit të vazhdueshëm të tij.

Në nenin 6 të LDI parashikohet se: “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi...”. Në zbatim të shkronjës c) të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 6 të LDI, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar Urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020, “Për miratimin e Programit të Transparencës të rishikuar”, i ndryshuar (në vijim Urdhëri nr. 187/2020), i cili është publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 224 datë 22.12.2020¹.

Gjithashtu, referuar shkronjës f) të nenit 9/1 të LDI, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale: “f) bën rekomandime për autoritetet publike lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës”.

Për sa më sipër, autoriteti publik ka detyrimin të vendosë në zbatim programin institucional të transparencës, sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me Urdhrin nr. 187/2020, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë.

Konkretisht, bazuar në urdhrin e sipërcituar, të gjitha autoritetet publike përgatisin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre zyrtare të internetit rubrikat/kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Hyrje;
- Rreth Autoritetit: një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;
- Kuadri ligjor rregullator: tekstet e plotë;
- E drejta për t’u informuar dhe për t’u ankuar: informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ushtrimit të mjeteve ligjore administrative;
- Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi autoritetin publik;
- Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të autoritetit publik;
- Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/ partneritetit publik/privat;
- Shërbimet që ofrohen nga autoriteti publik;
- Procedurat/mekanizmat për të dhënë vendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;
- Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve;
- Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve;
- Ndihma shoqërore/subvencionet të dhëna nga autoriteti publik;

¹ <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/12/18/187/eac66214-1453-4b4f-878e-50d3118f702d;q=urdher%20187%20date%2018.12.2020>

- Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikun nga autoriteti publik.

Informacioni duhet të publikohet i përditësuar, në çdo rast që pëson ndryshime, duke shënuar edhe datën e përditësimit të fundit.

Autoriteti publik rekomandohet të përfshijë në programin e transparencës gjithashtu vendime të rëndësishme të tij, udhëzime të përgjithshme të detyrueshme, si dhe çdo informacion që çmohet i dobishëm për qytetarët.

Për lehtësinë tuaj, Programin model të Transparencës, po jua bashkëlidhim këtij rekomandimi me CD. Gjithashtu bëjmë me dije se Zyra e Komisionerit ka hartuar udhëzime/rekomandime lidhur me vënien në zbatim të programit institucional të transparencës dhe mbetet në dispozicion të autoriteteve publike, mbi nevojat e tyre për paqartësi/informacion/rritje kapacitetesh, lidhur me zbatimin e legjislacionit për të drejtën e informimit.

Me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e të drejtës së informimit, autoritetet publike kanë detyrimin ligjor të caktojnë një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit. Pika 1 e nenit 10 të LDI, përcakton se: *“1. Titullari i autoritetit publik cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit. Menjëherë pas caktimit ose ndryshimit të koordinatorit për të drejtën e informimit, titullari i autoritetit publik i njofton Komisionerit emrin dhe kontaktet e nëpunësit”*.

Koordinatori për të drejtën e informimit ka detyrimin e ushtrimit të kompetencave të parashikuara në pikën 2 të nenit 10 të LDI, ku ndër të tjera është përgjegjës për bashkërendimin e punës për trajtimin e kërkesave për informacion të qytetarëve, si dhe për mbajtjen dhe përditësimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Në pikën 1 të nenit 8 të LDI parashikohet se: *“Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet jo më pak se 1 (një) herë në muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuësve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër”*.

Pika 2 e nenit 8 të LDI parashikon se: *“Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos standarde për formatin dhe përmbajtjen e regjistrit”*.

Për sa më sipër, Komisioneri ka miratuar formatin dhe përmbajtjen e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve me Urdhrin nr. 188, datë 18.12.2020 *“Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, të rishikuar”*.

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të patur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë.

Nga ana tjetër, Programi model i Transparencës dhe Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve përfaqësojnë instrumentet kryesore të promovimit të transparencës proaktive të autoriteteve publike dhe garantimit të së drejtës për informim të publikut dhe çdo autoritet publik është i detyruar ligjërisht t'i vërë ato në zbatim.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 4, 6, 7, 8, shkronjës f) të nenit 9/1, si dhe shkronjës b) të pikës 2 të nenit 10 të LDI,

REKOMANDOJ:

1. Autoriteti Publik Spitali Rajonal Durrës të vërë në zbatim, publikojë, pasqyrojë, përditësojë, ndërlidhë në programin e transparencës të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publike, në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, i ndryshuar, Urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020, *“Për miratimin e Programit të Transparencës të rishikuar”*, të ndryshuar të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe këtij Rekomandimi brenda një afati 90 ditë nga momenti i marrjes dijeni të tij.
2. Autoriteti Publik Spitali Rajonal Durrës, në rast ndryshimi të koordinatorit për të drejtën e informimit, t'i njoftojë Komisionerit emrin dhe kontaktet e nëpunësit, në përputhje me pikën 1 të nenit 10 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”* i ndryshuar.
3. Koordinatori për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik Spitali Rajonal Durrës të krijojë, mbajë, bëjë publik dhe përditësojë Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, në përmbushje të detyrimeve të shkronjës b) të pikës 2 të nenit 10 dhe në zbatim të pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, të ndryshuar dhe sipas Urdhrit nr. 188 datë 18.12.2020 *“Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, të rishikuar”* të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas neneve 18 dhe 19 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, i ndryshuar.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 10.04.2025 dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Komisionerit.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi